



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM  
PËR MBLEDHJE PLENARE  
**27 TETOR 2023**

**Informacion mbi mbledhjen:**

<b>Dita/Data:</b>	E premte, 27.10.2023
<b>Ora:</b>	10.00
<b>Kohëzgjatja:</b>	~ 60 min
<b>Thirrur nga:</b>	Kryetari i Këshillit
<b>Pjesëmarrësit:</b>	Anëtarët
<b>Kuorumi i nevojshëm:</b>	7 anëtarë

*Kjo mbledhje do të organizohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, në prezencë të Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të ftuar përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Programi OPDAT dhe EU4JUSTICE. Media si gjithmonë është e ftuar të jetë e pranishme.*

**Rendi i ditës:**

1. Diskutimi/miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare të datës 05.10.2023.
2. Diskutimi/ miratimi i projektaktit për “Verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për programin e formimit fillestar të shkollës së magjistraturës në vitin akademik 2022-2023, Znj. Anisa Gju”.
3. Diskutimi/ miratimi i projektaktit për “Plotësimin e 1 (një) pozicioni, për këshilltar ligjor, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përmes procedurës së komandimit të prokurorëve”.
4. Diskutimi/ miratimi i projektaktit për “Plotësimin e 1 (një) pozicioni si ndihmësmagjistrat pranë Prokurorisë së Përgjithshme përmes procedurës së komandimit të prokurorëve”.
5. Diskutim/miratim i projekt vendimit mbi kërkesën e prokurores Sonila Muhametaj për përjashtimin e dy anëtarëve të Këshillit nga procesi i vlerësimit të kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Urdhërohet sektori i dokumentimit të seancave të bëj publikimin e kësaj axhende në faqen web të Këshillit.

Njoftohen të gjithë anëtarët e Këshillit për të siguruar pjesëmarrjen.

**Kryetar**  
**Alfred Balla**